



## PROJEKTLIGJ “PËR INSPEKTIMIN NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

### Raport për rezultatet e konsultimeve publike

#### 1. Titulli i draft aktit

Projektligj “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

#### 2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Konsultimi paraprak i këtij projektligji me aktorët e përfshirë, ka nisur që në fazën e hartimit të draftit në dhjetor të vitit 2023. Konsultimet në Regjistrin Elektronik të Njoftimeve dhe Konsultimeve Publike: 20 ditë pune (31 Maj 2024 – 28 Qershor 2024).

#### 3. Metoda e konsultimit

Metodat e përdorura për konsultimin publik të projektligjit “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë” janë:

1. Njoftimi paraprak mbi projektligjin “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe reformën në inspektive u bë më 14 Maj 2024, në takim të zhvilluar nga Kryeministri me përfaqësues nga institucionet publike (inspektorate) dhe përfaqësues nga dhomat e biznesit vendase. Më tej ky proces është vijuar nga Ministri i Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit dhe Inspektori i Përgjithshëm përmes daljeve publike në media.
2. Konsultimi në faqen zyrtare të konsultimit publik, RENJK, për periudhën 31 Maj 2024 – 28 Qershor 2024, gjatë së cilës është përcjellë një koment përmes këtij portali.
3. Më datë 21 Qershor, në Tirana International Hotel, u mbajt një takim ku u diskutua me ekspertë, akademikë dhe grupet e interesit lidhur me Projektligjin “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”

#### 4. Palët e interesit të përfshira

Hartimi i projektligjit ka kaluar përmes një dialogu të vazhdueshëm me Inspektoratin Qendror për diskutimin e problematikave dhe formulimin e parashikimeve të duhura ligjore.

Procesi i hartimit të këtij projektligji ka kaluar përmes disa ndryshimeve me qëllim reflektimin e komenteve të aktorëve të përfshirë, si dhe përputhshmërinë e tij me Kushtetutën dhe parashikimet e tjera ligjore. Në përfundim të këtij procesi, projektligji i është nënshtruar konsultimit publik përmes publikimit të tij në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike.

Më datë 21 Qershor 2024 është zhvilluar takimi konsultativ me përfaqësues nga dhomat e tregtisë dhe industrisë dhe shoqatat e biznesit vendase dhe të huaja, ekspertë individualë dhe përfaqësues nga bota akademike si: Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë, Dhoma Amerikane e Tregtisë dhe Industrisë, Dhoma Britanike e Tregtisë dhe Industrisë, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, Forumit Ekonomik Mbarëshqiptar, Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë, Kryetar i Shoqatës së Ricikluesve Shqiptarë/EDIPACH, Këshilli i agrobiznesit, Shoqata e Konvertuesve të Plastikës së Shqipërisë, Shoqata e Industrisë së Bimëve Mjekësore dhe Aromatike, Bashkimi Prodhuesve Shqiptarë, Shoqata Shqiptare e Turizmit, prof. dok. Et'hem Ruka, Rektor i Universitetit Luarasi, prof. dok. Adrian Civici, Rektor i Universitetit "Mesdhetar të Shqipërisë", përfaqësues të bizneseve etj.

#### 5. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/ refuzuara

Nga konsultimi publik i kryer në Regjistrin elektronik, në zbatim të ligjit nr. 146/2014, "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik" ka pasur një koment me propozime të caktuara mbi përmbajtjen e projektligjit. Pranë Inspektoratit Qendror është administruar në formë elektronike një koment me propozime për projektligjin.

Çështja e adresuar (p.sh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	Komenti (grumbulloni dhe përmbledhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
Parashikueshmëria Institucionale	Në një periudhë prej gati 10 vjetësh, ka pasur propozime dhe ndryshime të vazhdueshme në sistemin e inspektimit, duke kaluar nga një model i centralizuar në një model decentralizimi dhe më pas rikthim në një model centralizimi. Këto ndryshime të shpeshta dhe të		I pranuar	Objektivi parësor dhe gjithëpërfshirës i një reforme në fushën e inspektimeve është përmirësimi i klimës së biznesit. Ligji aktual për inspektimin ka hasur problematika në zbatim, të

	<p>paparashikueshme mund të krijojnë pasiguri në sistemin e inspektimit dhe mund të pengojnë përmirësimin e këtij sistemi. Është e rëndësishme që ndryshimet ligjore të jenë të qëndrueshme dhe të koordinuara në mënyrë që të lejojnë zhvillimin e qasjeve afatgjata dhe efikase për të reduktuar barrën administrative mbi bizneset.</p>	<p>Dhoma Amerikane e Tregtisë</p>		<p>lidhura kryesisht me arsye strukturore. Ky ligj nuk ka mundur të vendosjen e një komunikimi të rregullt institucional midis Inspektoratit Qendror, inspektorateve të tjera dhe ministrive përgjegjëse në fushën e inspektimit. Vështirësi të tjera janë krijuar si pasojë e mbivendosjes së funksioneve të inspektimit në struktura të ndryshme, mos përmirësimi i sistemit elektronik të inspektimit, diskutimet e vendosjet e sistemeve të riskut në inspektorate specifike, organizimet e trajnimeve, marrëdhëniet e punësimit të inspektorëve me dy standarde, etj. Ndaj synohet të arrihet bashkërendim dhe konsolidim i proceseve të inspektimit, pa mbivendosje kompetencash ndërmjet organeve të ndryshme, si edhe përdorim më i mirë i burimeve njerëzore dhe publike në fushën e inspektimit.</p>
<p>Përfshirja e ligjeve të posaçme të Inspektoriateve:</p>	<p>Propozimi aktual i projektligjit “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, duket më shumë parimor në natyrë dhe nuk përfshin në mënyrë të mjaftueshme ligjet specifike që rregullojnë funksionimin e inspektoriateve të ndryshme. Është e nevojshme që reforma të përfshijë një përmirësim të strukturuar dhe të qëndrueshëm të legjislacionit aktual, duke siguruar që të gjitha aspektet e inspektimit të jenë të rregulluara dhe të koordinuara në mënyrë efektive. Kjo përfshirje e detajuar do të ndihmojë në hartimin e një reforme të shtrirë dhe të saktë që do të sigurojë funksionimin e përshtatshëm të</p>	<p>Dhoma Amerikane e Tregtisë</p>	<p>I pranuar</p>	<p>Ky ligj synon krijimin e mundësive për një riorganizim të inspektorateve në bazë të fushave të lidhura me risqet e ngjashme, në bazë të metodologjisë dhe fushave të inspektimit të sugjeruara nga OECD dhe e zbatuar në disa shtete ku ka pasur reforma thelbësore në këtë fushë. Po ashtu, pritet që nga riorganizimi i veprimtarive inspektuese, funksionet administrative të ushtrohen më me eficiencë, në kohë dhe cilësi, si dhe</p>

	<p>institucioneve në fushën e inspektimit. Një reformë sistematike e inspektimit duhet të përmbushë standardet për përmirësimin e aspekteve ligjore dhe institucionale. Vetëm nëse zbatohet me efikasitet, kjo reformë mund të ndihmojë në uljen e barrës administrative për bizneset dhe në përmirësimin e klimës së biznesit në vend.</p>			<p>ushtrimi i kompetencave institucionale në mungesë të konfliktit të interesit. Rregullimi i të gjitha hallkave të procesit inspektues, do t'i ofrojë biznesit një qasje më transparente të veprimtarive inspektuese dhe eficiente, duke filluar nga ofrimi i informacionit të nevojshëm për bizneset e reja, cilësia e inspektimeve e fokusuar në këshillim, thjeshtësia në aplikimet dhe përcjelljen e dokumentacionit të inspektimit në kohë reale, mungesa e inspektimeve të shpeshta.</p>
<p>Neni 7: “Çdo subjekt inspektohet mbi bazën e programit të inspektimit. Përrjashtimisht, një subjekt mund të inspektohet jashtë programi në rastet e parashikuara shprehimisht me ligj”.</p>	<p>Mendojmë se do të ishte më e përshtatshme që rastet përjashtimore të specifikohen në këtë ligj. Të mos lihet evazive për arsye se krijon mundësinë për interpretime/keqinterpretime në praktikë.</p>	<p>Dhoma Amerikane e Tregtisë</p>	<p>I refuzuar</p>	<p>Ky nen parashikon një ndërparimet e inspektimit që është programimi i inspektimeve, që lidhet me pikën 1, të nenit 32, sipas të cilit: “Çdo inspektim i programuar autorizohet mbi bazën e programit të inspektimit”. Raste përjashtimore sipas të cilave inspektimi mund të autorizohet jashtë programit të inspektimit, janë të përcaktuara në nenin 33, dhe konkretisht: si pasojë e informacionit të marrë nga një institucion publik vendas apo i huaj ose një organizatë ndërkombëtare, ndodhin ngjarje, aksidente, apo incidente që kanë cenuar apo përbëjnë rrezik për të cenuar të drejta dhe interesa të tjera të ligjshme të personave të ndryshëm apo interesin publik, si dhe kur parashikohet nga ky ligj dhe shprehimisht nga ligji i</p>

				<p>posaçëm. Në kushtet kur ligji për inspektimin synon përcaktimin e parimeve të përgjithshme, nuk mund të parashikojë në formë shteruese të gjitha rastet përjashtimore, pasi çdo inspektorat ka specifikën e vet sipas fushës së inspektimit. Në rastet specifike të nenit 32 dhe 33, përfshirja e rasteve përjashtimore në formën e autorizimeve për inspektimet jashtë programit (neni 33) ose procedurave të inspektimit të programuar (neni 32) shërben për të strukturuar dhe limituar autoritetin e inspektorëve në kryerjen e veprimeve të tyre, duke garantuar se këto veprime janë të justifikuara, të bazuara në risk dhe në përputhje me nevojat emergjente ose situata të paqëndrueshme. Kjo minimizon mundësinë e abuzimit të fuqisë dhe rrit efikasitetin dhe efektivitetin e veprimtarisë së inspektimit në përgjithësi.</p>
<p>Neni 8, pika 2. “Kur subjekti i inspektimit vepron në përputhje me një dispozitë ligjore që bie në kundërshtim me një dispozitë tjetër të të njëjtit ligj, veprimi i tij nuk konsiderohet shkelje”.</p>	<p>Edhe në këto raste nuk duhet të çenohet/rëndohet pozita e subjektit të inspektimit. Ligji nëpërmjet këtij parashikimi referon se mund të kemi mbivendosje apo dispozita kundërshtuese me ligje të tjera. Ky kontroll ligjshmërie duhet bërë përpara propozimit të këtij projektligji.</p>	<p>Dhoma Amerikane e Tregtisë</p>	<p>Pjesërisht i pranuar</p>	<p>Neni 8 parashikon parimin e dispozitës më të favorshme ligjore, me qëllim lehtësimin e pozitës së subjektit të inspektimit, pasi edhe në pikën 1, përcakton se trupa inspektuese mbështetet në dispozitat e këtij ligji dhe ndërmerr veprime që cenojnë më pak subjektin e inspektimit. Në përgjithësi, përjashtimet janë mjetet ligjore që lejojnë një zbatim më të matshëm dhe të drejtë të ligjit, duke siguruar që ai të</p>

				funksionojë në mënyrë që të mbështesë jo vetëm zbatimin e ligjeve por edhe parimet e drejtësisë dhe efikasitetit. Lidhur me mbivendosjen e dispozitave ligjore, një ndër qëllimet prioritare të reformës ka qenë eliminimi i mbivendosjeve ligjore dhe kompetencave, ndaj ligji për inspektimin në dispozitën kalimtare do të përcaktojë edhe të gjitha dispozitat ligjore sektoriale që duhet të ndryshohen apo shfuqizohen, me hyrjen në fuqi të këtij projektligji.
Neni 40, pika 1: “Inspektimi i bëhet i ditur subjektit nëpërmjet njoftimit paraprak të autorizimit për kryerjen e inspektimit, me mjete elektronike (online) ose në forma të tjera të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, në çdo rast jo më vonë se 7 ditë përpara fillimit të procedurës së inspektimit”.	Sugjerojmë që është më e përshtatshme që ky afat të jetë më i gjatë se 7 ditë, p.sh. të paktën 15 ditë pune.	Dhoma Amerikane e Tregtisë	Pjesërisht i Pranuar	Ky koment është reflektuar pjesërisht dhe konkretisht, pika 1, e nenit 40 është ndryshuar:  “Inspektimi i bëhet i ditur subjektit nëpërmjet njoftimit paraprak të autorizimit për kryerjen e inspektimit, me mjete elektronike (online) ose në forma të tjera të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, në çdo rast jo më vonë se 10 ditë përpara fillimit të procedurës së inspektimit”
Neni 43, pika 4: “Në rastin kur nuk janë konstatuar shkelje të kërkesave ligjore gjatë procedurës së inspektimit, trupa inspektuese mbyll procesverbalin dhe merr vendim përfundimtar në vend. Procesverbali dhe vendimi përfundimtar	Sugjerojmë që të lihet dhe mundësia e njoftimit me postë fizike, jo vetëm nëpërmjet postes elektronike.	Dhoma Amerikane e Tregtisë	I pranuar	Në nenin 43 të projektligjit u shtua edhe njoftimit nëpërmjet shërbimit postar.

mbahen në vendin e inspektimit dhe i njoftohen subjektit të inspektimit nëpërmjet postës elektronike”.				
Neni 44, pika 4: “Dënimi administrativ kryesor me paralajmërim nuk zbatohet në rastet e shkeljeve të rënda për të cilat parashikohet masa e pezullimit të aktivitetit, sipas ligjit të posaçëm”.	Duhet të specifikohen se cilat konsiderohen si shkelje të rënda.	Dhoma Amerikane e Tregtisë	I refuzuar	Neni 44 , pika 4, përcakton se në ato raste kur ligji i posaçëm për një shkelje të caktuar parashikon “pezullimin” atëherë trupa inspektuese nuk zbaton detyrimin për të vendosur dënimin administrativ kryesor me paralajmërim. Këto shkelje përcaktohen në ligje të posaçme. Për shkak të specifikave të fushave inspektuese, ligji për inspektimin nuk mund të përcaktojë në formë shteruese të gjitha shkeljet e rënda sipas fushave përkatëse të inspektimit. Nëpërmjet akteve nënligjore, këto shkelje do të përcaktohen në bashkëpunim me inspektorate qendrore dhe me përfaqësues të biznesit si pjesë e Bordit të Inspektimit.
Neni 48, pika 2: “Kur pjesëmarrja, gjatë kryerjes së inspektimit, sipas shkronjës “ç” të pikës 1, të këtij neni, pengon kryerjen e veprimeve të inspektimit, trupa inspektuese mund të vendosë përjashtimin nga pjesëmarrja. Vendimi pasqyrohet në procesverbal dhe nuk mund të ankimohet veçmas vendimit	Kjo pikë duhet të rishikohet që të mundësohet ankimimi i këtyre vendimeve.	Dhoma Amerikane e Tregtisë	I refuzuar	Subjekti i inspektimit mund ta ushtrojë të drejtën e ankimit pas marrjes së vendimit përfundimtar të inspektimit. Ankimi në këtë fazë të inspektimit, do të zgjasë shumë procesin administrativ të inspektimit, duke ndikuar në eficiencën dhe efektivitetin e procedurës së inspektimit. Për rrjedhojë, pengon ecurinë e procesit të inspektimit dhe ushtrimin e pavarësisë në vendimmarrje të trupës inspektuese.

përfundimtar të inspektimit”.				
Neni 52: “Marrja e kopjeve dhe sekuestrimi i dokumenteve”.	Sekuestrimi i dokumenteve duhet të bëhet në bazë të legjislacionit në fuqi. Bazuar në Kodin e Procedurës Penale, sekuestrimi bëhet nga gjykata ose prokurori. Sugjerojmë se ky nen i ligjit duhet të ndryshohet.	Dhoma Amerikane e Tregtisë	I refuzuar	Referuar ligjeve sektoriale, disa inspektorate kanë të drejtë të sekuestrojnë dokumentacionin e nevojshëm për të verifikuar zbatimin e dispozitave ligjore. Për shembull: Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Sociale, në rastet e inspektimeve të kushteve të punës, sigurisë dhe shëndetit në punë, ka të drejtën të kërkojë dhe, në raste të caktuara, të sekuestrojë dokumentacionin e nevojshëm për të verifikuar zbatimin e legjislacionit të punës. Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit ka kompetenca për të inspektuar dhe sekuestruar dokumente në lidhje me zbatimin e ligjeve për planifikimin dhe mbrojtjen e territorit. Strukturat përgjegjëse për kontrollin dhe procesin e inspektimit në pyje, nëse konstatojnë shkelje, ndërmarrin masa parandaluese dhe sanksione administrative, ku një ndër to është edhe “bllokimi, sekuestrimi dhe konfiskimi i prodhimeve drusore dhe jodrusore të siguruara në mënyrë të kundërligjshme, mjetet që kanë shërbyer për kryerjen e kundërvajtjes, si dhe çdo produkt ose përfitim pasuror të arritur përmes tyre, duke i kaluar në llogarinë e institucionit për pyjet”. Në këto kushte, duke qenë se ligji i posaçëm ia ka dhënë këtë të drejtë strukturës përgjegjëse inspektuese,



				ky parashikim është vlerësuar të qëndrojë në projektligjin për inspektimin, duke se qenë se është ligj rregullator.
Mbrojtja e të dhënave personale	<p>Koment 1: Neni 54, pika 2: “Nëse është në interes të personit të tretë dhe mbrojtjes së të drejtave ligjore të tij, inspektorati mund të urdhërojë kryerjen e publikimit të vendimit përfundimtar apo të një përmbledhjeje të tij”. Ky paragraf bie ndesh me nenin 10.2, ku të dhënat/informacioni trajtohet në mënyrë konfidenciale në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.</p> <p>Koment 2: sipas këtij ligji Trupa inspektuese ka e drejte te kryeje fotografime filmime dhe regjistrime te gjithçkaje qe ndodhet ne subjekt dhe ne dy pika te ndryshme është e parashikuar se Inspektorati ne varësi te rasteve te parashikuara ne këtë ligj, ka te drejte te publikoje Vendimin final (i cili mund te përmbajë këto filmime/fotografime), megjithatë përmendet gjithashtu se te dhëna dhe konfidencialitet te subjektit do te ruhen por nuk është shume e qartë se cilat te dhëna apo konfidencialitetet ruhen dhe çfarë ndodh ne rast se dalin, kush mban përgjegjësi për demin qe mund te vlerësohet?</p>	Dhoma Amerikane e Tregtisë  Përfaqësues nga biznesi	I refuzuar	<p>Në lidhje me këtë çështje theksojmë se legjislacioni në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, është i detyrueshëm për zbatim nga të gjitha institucionet /autoritetet publike. Për, rrjedhojë edhe në rastin e parashikuar nga neni 54 i projektligjit, kjo procedurë do të bëhet duke respektuar detyrimisht legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.</p> <p>Aktualisht, në zbatim edhe të Rregullores për mbrojtjen e të dhënave personale gjatë procesit online të inspektimit, provat e regjistruara me video dhe audio regjistrim nuk janë pjesë e mbikëqyrjes as nga specialisti në Inspektoratin Qendror, sepse kjo është një provë e cila merret me kërkesë të prokurorit, policisë së Shtetit apo vendim të gjykatës.</p>
Neni 57, pika 1: “Moskorrigjimi i shkeljeve nga subjekti i inspektimit brenda afatit, përbën kundërvajtje administrative sipas përcaktimit në pikën 4 të nenit 44, të këtij ligji...”	Afati i lënë në dispozicion të subjektit duhet të jetë i arsyeshëm. Në çdo rast jo më pak se 30 ditë. Kjo duhet të specifikohet në ligj.	Dhoma Amerikane e Tregtisë	I refuzuar	Referuar nenit 44, pika 5, është përcaktuar vendosja e një afati të arsyeshëm. Ky afat nuk mund të përcaktohet në formë eksplicite në ligjin për inspektimin, për shkak edhe të kompleksitetit apo specifikës së secilës strukturë inspektuese sipas fushës përkatëse të inspektimit.

<p>Neni 58, pika 4. "Aktet nënligjore në fuqi, të cilat nuk bien në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, vazhdojnë të mbeten në fuqi, deri në daljen e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji".</p>	<p>Në praktikë kjo dispozitë mund të përbëjë shkak për të krijuar konfuzion tek subjektet e inspektimit si dhe tek vetë inspektorët. Prandaj sugjerojmë që të rishikohet si pikë. Sugjerojmë që të bëhet një analizë paraprake se cilat mund të jenë ligjet dhe aktet nënligjore që mund të bien në kundërshtim me këtë ligj në mënyrë që të shfuqizohen. Këto janë tagra të ligjvënësit pra propozuesit të projektligjit.</p>	<p>Dhoma Amerikane e Tregtisë</p>	<p>I pranuar</p>	<p>Që në momentin e draftimit të projektligjit për inspektimin është vijuar paralelisht edhe analiza për identifikimin e akteve ligjore dhe nënligjore që bien ndesh me parashikimet e ligjit për inspektimin. Në kushtet kur projektligji për inspektimin parashikohet të hyjë në fuqi 6 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare, është i nevojshëm përcaktimi se aktet nënligjore që nuk bien ndesh do të zbatohen me qëllim shmangien e mungesës së një rregullimi ligjor, deri në miratimin e akteve nënligjore që do të dalin në bazë dhe për zbatim të projektligjit për inspektimin.</p>
<p>Neni 59, pika 2. "Ngarkohet organi ekzekutiv i çdo njësie vendore të miratojnë rregulloren e parashikuar në pikën 6 të nenit 44 të këtij ligji"</p>	<p>Sugjerojmë që të ketë një afat për miratimin e aktit nënligjor (rregullores).</p>	<p>Dhoma Amerikane e Tregtisë</p>	<p>I pranuar</p>	<p>Neni 59, në fund të fjalisë shtohet togfjalëshi "brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji".</p>
<p>Përcaktimi i numrit maksimal të inspektimeve të programuara në ligj.</p>	<p>Numri maksimal i inspektimeve të programuara në një vit për subjektin është i pa përcaktuar. Nëse një nga synimet e ligjit është ulja e numrit vjetor të inspektimeve totale të biznesit, kjo gjë duhet të pasqyrohet.</p>	<p>Përfaqësues të biznesit</p>	<p>I refuzuar</p>	<p>Ky parashikim do të rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave, i cili përmes miratimit të rregullave themelore të përgjithshme mbi programimin e inspektimeve, do të përcaktojë edhe përqindjen e inspektimeve jashtë programit, e cila nuk duhet të tejkalohet nga strukturat inspektuese. (Neni 33, pika 5).</p>
<p>Programimi i inspektimeve vjetore</p>	<p>Koment/Pyetje: Është e paqartë se ku do të bazohet metodologjia apo nëse vlerësimi i riskut bëhet në bazë të një kategorie të caktuar?</p>	<p>Përfaqësues të biznesit</p>	<p>-</p>	<p>Rregullat e përgjithshme për programimin e inspektimeve dhe metodologjinë e vlerësimit të</p>

bazuar në metodologjinë e vlerësimit të riskut				riskut do të përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. (Neni 32, pika 7)
Marrja e mostrave	Subjekti duhet të ketë të drejtë dhe të jetë i përfaqësuar dhe i pranishëm gjatë marrjes së mostrave në subjekt	Përfaqësues të biznesit	I pranuar	Ky parashikim është në nenin 48 “Të drejtat e subjektit të inspektimit”, ku ndër të tjera subjekti i inspektimit ka të drejtë të jetë prezent dhe të ndjekë vetë ose nëpërmjet përfaqësuesit të tij, të gjitha veprimet e inspektimit.
Institucionet kontrolluese	Të ketë sa me pak institucione kontrolluese dhe thjeshtimi i procedurave të bashkëpunimit mes institucioneve shtetërore dhe biznesit	Kryetari i Dhomës Britanike të Tregtisë në takimin konsultativ	I pranuar	Fushat e inspektimit do të jenë të njëjtat por qëllimi i kësaj reforme është shmangia e dublikimeve dhe mbivendosja e kompetencave, e cila ka qenë një ndër problematikat e evidentuara që përpara draftimit të projektligjit.
Metodologjia e vlerësimit të riskut dhe marrëdhëniet e punësimit	Ky është një rregullim që ndihmon derregullimin dhe elementët e këtij projektligji lidhur me riorganizimin e inspektorateve shkojnë me këtë filozofi, jo thjesht si marrje eksperience nga vendet e BE-së, por si një ristrukturim që i përgjigjet shumë mirë nevojave dhe sfidave të vendit tonë. Pozitive për biznesin është dhe ulja e numrit të inspektimeve, të cilat shpesh herë bëhen formale, me tendencë dhe me pasoja jo të dëshirueshme. Inspektimi do të ketë vlerë, duke mos ndëshkuar por duke e këshilluar dhe informuar për ta korrigjuar. Duke qenë se inspektimet parashikohen të kryhen në bazë të riskut, a ka indikatorë të përcaktuar dhe kush i përcakton dhe i evidenton që më pas të kryhet i gjithë procesi mbi bazën e riskut? Së dyti, lidhur me marrëdhëniet e punësimit, me çfarë fryme do të jetë punësimi, vetëm me kodin e punës apo edhe me elementë të nëpunësit civil, pasi është shumë pozitive parashikimi lidhur me punësimin dhe ecurinë në karrierë?	Koment/Pyetje nga përfaqësues nga bota akademike në takimin konsultativ	-	Lidhur me riskun, nuk ka një institucion që do të merret me riskun. Gjithë elementi i riskut fillon me ndërtimin e një databaze, përpara përcaktimit të indikatorëve, ku secili biznes do të ketë një profil me të dhëna të përcaktuara, statike dhe dinamike, të cilat do i shërbejnë çdo inspektorati, me qëllim që më pas të krijojnë modelet e riskut. Kjo databazë do të ketë ndërveprim me shumë databaza të tjera (tatimet, doganat, OSHEE etj.) në bazë të kërkesave për informacion që do të vijnë nga inspektoratet teknike. Kjo databazë do të aksesohet nga të gjitha inspektoratet dhe secili inspektorat do të ndërtojë modelin e vet të riskut duke marrë të dhëna prej saj dhe do të gjenerojë më pas

			<p>subjektet për inspektim në bazë të një plani vjetor inspektimi. Përveç modelit individual të riskut, do të ketë dhe një model të përgjithshëm të riskut, i cili do të aplikohet për të gjithë inspektoratet. Lista e subjekteve të gjeneruar nga inspektoratet në bazë të modelit individual të riskut do të dërgohet tek Inspektorati i Përgjithshëm, i cili krahason dhe evidenton përplasjet e listave nga secili inspektorat, nëse ka mbivendosje dhe nevojë për koordinim dhe më pas hyn në modelin e riskut të Inspektoratit të Përgjithshëm. Në rast se një subjekt ka një risk zero apo një risk të ulët në riskun e përgjithshëm, atëherë ky subjekt nuk do të përfshihet në planin e inspektimit nga inspektoratet, duke ulur kështu barrën administrative.</p> <p>Lidhur me punësimin, në projektligj parashikohet krijimi i komisionit të rekrutimit me përfaqësimin e Inspektoratit të Përgjithshëm dhe inspektoratit qendror dhe me aktet nënligjore do të përcaktohen kushtet dhe kriteret për çdo pozicion. Sistemi i karrierës do të mundësojë ngritjen në detyrë nga pozicioni “inspektor” deri në pozicionin “Kryeinspektor Rajonal” apo “Kryeinspektor Qendror”. Marrëdhëniet e punës në inspektorate do të rregullohen sipas Kodit të Punës dhe jo me dy</p>
--	--	--	--

				forma siç janë aktualisht (Kod Pune dhe ligji për nëpunësin civil) dhe procedurat e emërimit, trajnimit, certifikimit të inspektorëve do t'i kryejë Inspektorati i Përgjithshëm, bazuar në modelet e vendeve të BE-së.
Trajnimi i inspektorëve	Vëmendje duhet t'i kushtohet trajnimit të trupave inspektuese, pasi është shumë e rëndësishme të kemi një trupë inspektuese profesionale. Gjithashtu, rëndësi duhet kushtuar edhe tek kontrolli me bazë risku dhe ngritjen e sistemit të riskut.	Përfaqësues nga biznesi në takimin konsultativ	I pranuar	Institutet e reja që parashikohen në këtë projektligj, si instituti i rekrutimit, komisioni i ankimit, komisioni i disiplinës, bordi i inspektimeve apo edhe përqendrimi i ankesave, janë elemente që do të garantojnë suksesin në procesin e trajnimit të inspektorëve.
Flagranca	Projektligji ndihmon në zgjidhjen e problemit të bezdisjes së biznesit duke u inspektuar nga disa inspektorate në një kohë të shkurtër duke shkaktuar kosto. Lidhur me shkelje flagrante, sugjeroi përcaktimin e qartë e rastit flagrantë dhe ndarjen e këtyre rasteve pasi mund të ketë abuzim nga ana e inspektorëve	Përfaqësues nga biznesi në takimin konsultativ	I pranuar	Neni 33, në pikën 4 përcakton se inspektimi jashtë programit në kushtet e flagrancës është kur trupa inspektuese konstaton se subjekti po ushtron një veprimtari në shkelje të kërkesave ligjore, e cila duhet dokumentuar me sende ose prova e materiale. Fillimi i inspektimit në rastet kur nga trupa inspektuese konstatohet në flagrancë shkelja e një kërkesë ligjore shoqërohet me nxjerrjen menjëherë të autorizimit nga ana e kryeinspektorit. Përcaktimi në aktet nënligjore do të bëjë të mundur që të mos lihet arbitraritet dhe paqartësi për të tilla elemente.